



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VIII**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale  
Mbledhja nr.93  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303  
Prishtinë, më 2 prill 2024, në orën 10:00

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Fatmire Kollçaku, Armend Zemaj, Labinotë Demi- Murtezi, Haxhi Avdyli, Mirsad Shkreta, Burim Meta, Bekim Haxhiu, Floretë Zejnullahu, dhe Shemsedin Dreshaj, anëtarë.

**Mungoi :** dhe Samra Ilijazi, anëtarë.

**Pjesëmarrës të ftuar :** Blerta Krasniqi, logopedë, Arben Hysenaj, dekan nga Kolegji Heimerer; Lekë Gjurgjiali, drejtor ekzekutiv, logoped nga OJQ “Zë” – Qendra Logopedike për Trajtim dhe Hulumtim; Dajana Ollrigj, Erza Millaku, Drenusha Rugova, Instituti Kosovar i Ergoterapisë; Gylten Derguti, Aferdita Gjoci, Shqipe Munishi, dhe Xhevahire Balaj –Mataj, grupi i specialistëve të supervizionit për Psikologji Klinike dhe Psikoterapi.

**Stafi mbështetës:** Shpresa Haxhijaj, koordinatore dhe Besim Haliti, zyrtar i lartë/analist.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Violeta Emini, KSHMS.

**Mbledhjen e kryesoi** Fatmire Kollçaku, kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Takim me shoqatën e logopedëve ( ora 10:00)**
- 3. Takim me Shoqatën e ergoterapistëve (ora 10:30)**
- 4. Takim me grupin e specialistëve të supervizionit për Psikologji Klinike dhe Psikoterapi ( ora 11:00)**

## 5. Të ndryshme.

### 1.Miratimi i rendit të ditës

*Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.*

### 1.Takim me shoqatën e logopedëve ( ora 10:00)

**Fatmire Kollçaku:** Temw e diskutimit me shoqatën e logopedëve, janë arritjet e tyre, synimet problemet me të cilat ballafaqohet kjo shoqatë. 2 prilli është dita botërore e autizmit, e cila është vendosur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të bashkuara, në vitin 2007, si një përpjekje për ti dhënë fund diskriminimit ndaj personave me autizëm. Dita botërore e autizmit synon të rrisë ndërgjegjësimin, lidhur me çrregullimet e spektrit të autizmit dhe përmirësimin e jetës së atyre që jetojnë me autizëm. Andaj edhe Komisioni ynë Parlamentar sot, në shënimin e kësaj dite, po e realizon këto takime më profesionistë dhe anëtarë të shoqatave të logopedëve të ergoterapistëve, dhe të specialistëve të supervizionit për psikologji klinike dhe psikoterapi. Ajo theksoi se zhvillimi diskutimit është lidhur me sfidat me të cilat ballafaqohen në ushtrimin e profesionit, këto shoqata si dhe për sfidat që kanë edhe ata që do të duhej të përfitonin nga njohurit dhe shkathtësitë me të cilat disponojnë këta profesionistë shëndetësorë.

**Lekë Gjurgjiali, drejtor ekzekutiv, logoped nga OJQ “Zë” – Qendra Logopedike për Trajtim dhe Huluntim:** Sfida kryesore në Kosovë është mungesa e profesionit të logopedisë në Qendra Mjekësore Familjare, i cili nuk është i integruar. Duhet të shtohet inspeksioni për logoped sepse në shumë raste ka të punësuar pa licencë. Një odë e logopedëve e ndarë veçmas për licencim, do të ishte hap i duhur për këtë profesion, pasi që logopedi është i inkuadruar vetëm në shërbim terciar në QKUK dhe ato nuk janë shumë, janë vetëm 4 (katër) ndërsa në QMF, nuk është i integruar. Edhe të pjesa e licencimit, logopedët në duhet të mbesin në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, dhe jo të licencohen në kuadër të Odave të Infermierëve të Kosovës, sepse deri në vitin 2023 nuk ka qenë as profesion i veçantë, kanë qenë psikolog, logoped, ergotereput, ndërsa nga viti 2024 psikologët janë ndarë. Sado që të dyja bashkëveprojnë ne mes veti, në parim janë profesione të ndryshme. “Shumica e rasteve kanë të bëjnë me fëmijë dhe është një pjesë e ndjeshme. E mira do të ishte me qenë një odë e veçantë që logopedët licencohen nga logopedët dhe pikët akredituese që i kanë të rëndësishme me u marrë nga trajnimet për logopedi.

**Blerta Krasniqi, logopede- Kolegji Heimerer:** Profesionin e logopedit fatkeqësisht nuk ekziston si term, vetëm si bashkëpunëtor në mungesë të moslicencimit si profesion dhe në mungesë të mosmiratimit të protokolleve për bashkëpunime tjera. Po ashtu, mungesa e ligjit për krijimin e odave, sepse rëndësia dhe përfshirja e logopedëve brenda institucioneve shëndetësore dhe qasja e intervenimit të hershëm, ndaj personave (pacientëve) në sistemet e hershëm edukative janë të rëndësishme për parandalimin e pengesës në të folur tek fëmijët.

**Bekim Haxhiu:** Sa i përket themelimit të Odës për logopedë, është paksa e vështirë me 250 logopedë, me themelua odë të veçantë. Në cilën shoqatë e shohin veten logopedët? Prej këtyre 250 të diplomuarave, logopedëve, a jetojnë në Kosovë?

**Lekë Gjurgjali:** E shohin të rëndësishëm themelimin e një ode të veçantë për logopedët. Shumica e këtyre, prej 250 të diplomuarave jetojnë në Kosovë

**Mirsad Shkreta:** Si e parashihni ju licencimin e tyre dhe si të bëhet sistemimi nëpër institucione edukative dhe shëndetësore?

**Lekë Gjurgjali:** E kanë të nevojshme arritjen e sistemimit, shumica e logopedëve punojnë pa licencë. Shërbimet që i ofrojmë janë pa pagesë, sfida më e madhe është mungesa e financimit. Kemi diskutuar me organizatat e Evropës, këtu nuk ofrohen as programe, hapi i parë duhet të mbetet lejimi i studimeve në këtë fushë, që do të kontribuonte në të ardhmen në vendin tonë.

**Shemsedin Dreshaj:** Problemi kryesor i logopedëve është definimi i statusit të tyre, andaj duhet të merret parasysh kërkesa e tyre për licencim e këtij profesioni. Problemet që i keni prezantuar do të i marrim në konsideratë. Unë një problem më të madh të padefinuar, po e shoh, ju jeni të padefinuar se a jeni brenda Ministrisë së Arsimit apo të Shëndetësisë. Këtu duhet të mendohemi, se ku ta adresojmë këtë problem.

**Haxhi Avdyli:** Prej 250 logopedëve së janë të diplomuar, vetëm 4 prej tyre janë të punësuar. Ky është një problem i madh, andaj sistemimi i logopedëve në Ministrinë e Shëndetësisë është i rëndësishëm. Ne, si legjislacion duhet të krijojmë mekanizma për funksionimin këtij profesioni. Duhet të propozohet oda e veçantë për licencimin e logopedëve, për faktin se Kosova i ka vetëm katër logopedë të punësuar dhe kjo nuk është në rregull, sepse profesionistët po shkojnë në Gjermani. Prandaj, tash, sistemimi i tyre në sistemin shëndetësor është i nevojshëm.

**Lekë Gjurgjali:** Numri prej 250 logopedëve të diplomuar, ku vetëm 27 prej tyre janë të licencuar, është një shifër alarmante, ndërsa në vitin 2020 kanë qenë të punësuar vetëm dy logopedë dhe tashmë më sa e di, janë katër. Deri në vitin 2023 nuk ka qenë profesioni logoped brenda Odës. Një problem në kuadër të MSh-së është se ajo nuk i licencion organizatat joqeveritare.

**Armend Zemaj:** Sa i përket çështjes, se licencimit për logoped, duhet të merren hapa lidhur me licencimi e tyre. Shoqata duhet të bëjë kërkesën më propozime konkrete dhe t'i paraqesin tek institucionet e duhura pastaj edhe ne si Komision funksional e kemi më të letë t'i adresojmë të institucionet përkatëse.

**Burim Meta:** Nevoja për logoped është madhe, duke filluar nga niveli i QMF-ve, dhe kërkesat e juve duhet adresuar tek institucionet përkatëse.

### **3.Takim me Shoqatën e ergoterapistëve (ora 10:30)**

**Dajana Ollrigj, Instituti Kosovar i Ergoterapisë:** Instituti i Ergoterapisë është themeluar në vitin 2017 nga Dr. Jennifer Caldwell, ergoterapeute skoceze dhe ish- ligjëruese, me qëllim të promovimit të ergoterapisë, ofrimit të trajnimit profesional të vazhdueshëm, monitorimeve profesionale dhe gjithashtu të mbrojtjes së interesave të ergoterapeutëve në Kosovë. Instituti është anëtar i WFOT (World Federation of Occupational Therapy), Federata Botërore e Ergoterapisë.

Ergoterapia si profil terapeutik ende po has në vështirësi rregullative. Për herë të parë si program studimor ka filluar nga Kolegji Heimerer në vitin 2012, dhe deri tani numëron mbi 130 ergotetrapeut dhe mbi 30 prej tyre janë të licencuar. Shqetësimi jonë konsiston në dy pika: Ergoterapia nuk është e profilizuar as e njohur si profesion shëndetësor, në sistemin e kujdesit shëndetësor, dhe nga Ministria e Shëndetësisë, që rrjedhimisht do të thotë se në institucione shëndetësore publike nuk ka pasur, e as nuk ka vende pune për ergoterapeut. Ergoterapia nuk listohet as si profesion, që mund të operojë në institucione shëndetësore private (klinika), si shkak i mospërfshirjes në udhëzimet e fundit administrative, që përcaktojnë kushtet për operim të profesioneve në institucionet private shëndetësore.

**Elsa Millaku, përfaqësuese nga Instituti Kosovar i Ergoterapisë:** Jemi përpjekur për të reklamuar për ergoterapi. Është një profesion shkencor shëndetësor që fokusohet për të ndihmuar njerëz që kanë probleme me shëndetin mendor apo fizik. Ne po fokusohemi në aktivitetet për kujdesin personal në shtëpi apo jashtë saj. Ergoterapistët janë duke u larguar nga Kosova, për shkak të mungesës së mjeteve të punës, dhe aktivitetet e tyre i kryejnë në shtëpi private dhe nuk punojnë në institucione publike. Arsyeja pse ka kaq pak profesionist të licencuar është pikërisht nga arsyet e lartcekura, mungesa e motivimit dhe gjithashtu shpenzimet e mëdha për të studiuar këtë drejtim, kanë zbehur interesimin e ergoterapeutëve. Kjo nuk len zgjidhje tjetër, ose ndërrim profesioni ose largim nga vendi. Jemi këtu për ta ndaluar këtë

**Drenusha Rugova, Instituti i Ergoterapisë,** Ky profesion nuk ekziston fare në Kosovë. Kjo e pamundëson që ky profesion të nis punën në institucione, qoftë private apo publike. Një tjetër problem, që e parashtruan ishte edhe mungesa e një udhëzimi administrativ që ua pamundëson të fillojnë punën në ndonjë klinikë. Ky profesion, me intervenimin e hershëm do t'ju ndihmojë fëmijëve për një zhvillim më të mirë.

**Haxhi Avdyli:** Për këto 3 shoqata duhet të propozohen oda të veçanta, si për logopedët, ergoterapeutët dhe për psikologët klinik, por duhet të bëhet analizë e thellë para së të krijohen më legjislacion. Në mënyrë që të i shtohen listës së Odave të profesionistëve shëndetësor, që të kenë një zë të tyre dhe të rritet inkorporimi i tyre, sepse nuk kemi hapur institucione arsimore për të ndërtuar profesione që do të shkojnë në Gjermani, kur kemi 250 logopedë dhe janë të punësuar vetëm katër në sistemin shëndetësisë, ndërsa 90% e tyre punojnë infermierë ose edhe profesione tjera, që nuk kanë lidhje me mjekësi, andaj kjo çështje duhet të rregullohet në aspektin ligjor.

**Mirsad Shkreta:** Për gjitha këto profesione që po diskutojmë, se pari shteti, në këtë rast institucionet arsimore, i kanë hapur këto drejtime pa planifikuar dhe analizuar mirë problemet që mund të dalin gjatë procesit, por tash këto kanë ndodhur si problem dhe nuk pas pasur ndonjë strategji afatgjatë së si do ti sistemojnë këto drejtim në profile të caktuara. Por, tani ne si komision duhet të dalim më rekomandim që këtyre profesioneve t'iu bëhet zgjidhje. Programet e akredituara duhet të licencohen, për të ardhmen, duhet të hapen vetëm në bazë të nevojave që i duhen shtetit.

**Burim Meta:** Nëse janë mbi 130 ergotetrapeut të diplomuar dhe vetëm mbi 30 prej tyre janë të licencuar, pse është ky dallim dhe mospërputhje e kaq e madhe?

**Floretë Zejnullahu:** Është shqetësuese për vet shtetin dhe shoqërinë, kjo dukuri që përfundon studimet në një program të caktuar dhe nuk ke mundësi për të ushtruar profesionin, andaj për çdo program që akreditohet, duhet lejuar licencimi.

**Armend Zemaj:** Është obligim institucioneve arsimore, të cilat e kanë lejuar dhe akredituar këtë drejtim, për të gjetur zgjidhje, që këto shërbime të kryhen edhe në Kosovë. Po ashtu, është detyrë jona si Komision, në aspektin ligjor për ta rregulluar këtë çështje.

**Labinotë Demi-Murtezi:** Duhet të bëjmë përpjekje për përballuar këto probleme, po ashtu, edhe institucionet përgjegjëse, duhet të angazhohen, përderisa ky drejtimi dhe drejtimet e tjera janë akredituar nga institucionet arsimore, atëherë edhe duhet të licencohen, sepse këto profile me këto shërbime i duhen shëndetësisë së vendit.

**Bekim Haxhiu:** Sa i përket drejtimin të Ergoterapisë, po shihet, nuk pasur ndërlidhje të duhur në mes Agjencisë për Akreditim, Ministrisë së Arsimit dhe të asaj për Shëndetësi. Lidhur me licencimin e profilit të këtij drejtimi, pajtohem që duhet t'ju bëjmë zgjidhje ligjore. Këtë vit kur të na vjen për miratimi Projektligji për shëndetësi dhe për sigurimet shëndetësore, gjatë fazës së shqyrtimit të tyre, do t'ju ftojme për të dhënë propozimet tuja për rregullimin këtij profesioni edhe ma anë të legjislacionit.

**Shemsedin Dreshaj:** Sa i përket licencimit të këtij drejtimi, pothuajse janë të ngjashme edhe në disa drejtime tjera të padefinuar mirë, pasi që në kohën kur është hapur si profil, nuk ka qenë i definuar, se cili institucion do ta licencojë këtë drejtim. Pajtohem që nuk ka pasuar koordinim si duhet në mes të Agjencisë për Akreditim dhe dy ministrive të linjës, prandaj të gjitha këto çështje që u janë paraqitur kërkojnë të rregullohen në aspektin legjislativ, sikurse profesionet tjera.

**Elsa Millaku, Instituti Kosovar i Ergoterapisë:** Për të u licencuar profesioni i Ergoterapisë, së pari duhet 6 muaj përvojë punë në institucionet publike. Kjo gjendje po i len profesionistët e ergoterapisë të painkuadruar në sistemin shëndetësor të Kosovës, pa vende pune, pa mundësi vetëpunësimi, të cilët kanë investuar jo pak në këtë drejtim. Ne jemi dëshmitar të tjetërsimit pothuajse total të profesionit tonë, sepse çdo ditë shohim shembuj ku terapistë nga fusha të përafërta marrin guximin dhe tejkalojnë kompetencat profesionale, duke zbatuar teknika të profesionit të ergoterapisë në punën e tyre. Gjithashtu, sot QKUK, nga vlerësimet në klinikat neurologjike, pediatrike e psikiatrike, referojnë klientët/ pacientët për shërbim të ergoterapisë me ose pa dijeninë që këtë shërbim nuk kanë se nga ta marrin, përpos në OJQ, që ofrojnë shërbime sociale e që kapaciteti është mjaft i vogël.

**Fatmire Kollçaku:** Puna e këtyre profesionisteve ka mbetur në gjysmë, përderisa nuk licencohen. E jona si Komision është që të rekomandojmë tek institucionet përkatës që t'ju gjejnë zgjidhje.

#### **4.Takim me grupin e specialistëve të supervizionit për Psikologji Klinike dhe Psikoterapi ( ora 11:00)**

**Gylten Derguti, grupi i specialistëve të supervizionit për Psikologji Klinike dhe Psikoterapi:** Jemi një grup i specialistëve të supervizionit, që kemi diplomuar në drejtimin psikologji klinike

dhe psikoterapi, dhe kemi specializuar në fushën e specializimit të supervizionit. Problemi është se në fushën e specializimit të supervizionit, nuk mund të licencohemi nga institucionet përkatëse. Ju kemi drejtuar me një kërkesë Ministrisë së Shëndetësisë, rreth moslicencimit dhe ende nuk kemi përgjigje. Kemi mbetur pa e ushtruar detyrën e profesionit të supervizionit dhe kërkesa e jonë është që të rritet rrolli psikologut klinik. Në emër të këtij grupi, kërkoj nga ju si Komision funksional që t'na ndihmoni në këtë drejtim, duke e adresuar edhe ju si ligjvënës këtë çështje tek institucionet përkatëse.

**Arben Hysenaj, dekan, Kolegji Heimere:** Profesionit i psikologut, së pari duhet të rregullohet më standardet e profesionit, në bazë të programit për çdo profil brenda fushës së psikologëve, dhe në bazë legjislativitetit, ndërsa të çështja licencimit janë kriteret që përcaktojnë licencimin dhe duhet nënshtruar standardeve, në mënyrë që profili i psikologëve të ndahet, në atë arsimor dhe klinik. Problemin që e kanë psikologët e diplomuar, është se edhe nuk po ju lejohet hapja zyrtare private për të konsultuar dhe trajtuar pacientët, edhe pse në vitin 2021 kemi filluar më drejtimin 3+2 si standard për të u licencuar. Nëse kjo çështje rregullohet më anë të legjislativitetit, atëherë problemet do të evitohen, andaj për këtë çështje, Ministra e Arsimit dhe Shëndetësisë, duhet të koordinohen në mënyrë që ta zgjidhin këtë problem.

**Fatmire Kollçaku:** Këto probleme i kemi edhe më specializime që nuk janë planifikuar dhe analizuar mirë, për nevojat e shërbimeve mjekësore që duhen të ofrohen nga spitalet rajonale dhe klinikat. Mirëpo, puna e juaj primare është pacienti, që e kryeni si psikologe klinike, pastaj për specializimet shtesë brenda profesionit tuaj, është krijuar ky konfuzion për licencim, se cili institucion duhet ta bëjë, atëherë në këtë drejtim duhet të gjejmë zgjidhje ligjore.

**Shemsedin Dreshaj:** Ashtu sikurse diskutuam për dy drejtimet e tjera, problemet po na shfaqen të ngjashme rreth licencimit të tyre edhe për grupin e specialistëve të supervizionit për Psikologji Klinike dhe Psikoterapi, andaj edhe kjo çështje kërkon të rregullohet më legjislativitetin.

**Shqip Munishi, grupi i specialistëve të supervizionit për Psikologji Klinike dhe Psikoterapi:** Kërkesa e tyre është të avancohen si supervizione klinike, pasi që ky drejtim është pjesë e programit që kemi diplomuar dhe përfunduar këtë drejtim të supervizionit dhe t'na lejohet ushtrimi i kësaj detyre.

**Bekim Haxhiu:** Për gjitha këto probleme që po na shfaqen, lidhur më programet e akredituara, që janë në kudër të mandatit që duhet të rregullohen nga Agjencia e Kosovës për Akreditim dhe Ministra e Arsimit, pasi që e kanë në fushëveprim edukimin, ndërsa, Ministra e Shëndetësisë në mandatin e saj e ka se duhet të ofrojë shërbime mjekësore dhe humane. Zgjidhja më e mirë do të ishte hartimi i Ligjit për profesione të caktuara dhe për specializime, sepse Kosovës i mungon ky ligj.

**Labiotë Demi-Murtezi:** Është shqetësues dhe për keqardhje, moslicencimin i specializimit të supervizionit, përderisa në këtë drejtim më të cilin kanë diplomuar, nuk po licencohen, andaj ne si komision duhet të kërkojmë mundësinë për përmirësime ligjore për zgjidhjen e problemit të tyre.

**Burim Meta:** Nga diskutuesit u potencua disa herë mungesa e legjislacionit përkatës. Ne si komision kemi treguar konsideratë për profilin e psikologëve dhe është e papranueshme që ju ende trajtoheni më Odën e Infermiereve. Në kuadër të Ligjit për Odat e profesionistëve shëndetësorë, që duhet të plotësohet dhe ndryshohet, duhet të parashihet dhe të themelohet edhe Oda e Psikologeve. Sa i përket moslicencimit të specializimit të supervizionit, rreth kësaj çështjeje, nuk e kemi asnjë informatë nga Ministra e Shëndetësisë, çka duhet të bëjmë për këtë çështje, ne duhet ta ftojme ministrin e Shëndetësisë, lidhur më kërkesën tuaj që keni adresuar në ministri, t'i pyesim se a kanë shqyrtuar kërkesën dhe cilat janë veprimet që pritet të ndërmerren për çështjen e licencimeve për të tri gupet që po diskutojmë sot, sepse është diskriminim moslicencimi i tyre.

**Shemsedin Dreshaj:** Përfundimi i kësaj mbledhje është, se kërkesat e të tre grupeve janë rregullimi i legjislacionit për këto kategori. Për t'i përmbyllur këto probleme që po na paraqiten për licencim të profesionistëve të caktuar, është se Ligjet duhet t'i paraprijnë reformës e jo e kundërta. Shëndetësia ka nevojë urgjente për reformë legjislative, hartimin e strategjisë për shëndetësi, ligjin për shëndetësi dhe për sigurime shëndetësore.

**Fatmire Kollçaku:** Në kuadër të mbledhjes, në bazë të fushëveprimit që kemi, do t'i adresojmë tek institucionet përkatëse të gjitha kërkesat dhe problemet që i kanë lidhur më profesionet e caktuara dhe për licencim. Kërkoj që kërkesat dhe propozimet e tyre t'i adresojnë edhe me shkrim të stafi i Komisionit.

## **5. Të ndryshme.**

*Për pikën të ndryshme, nuk pati ndonjë çështje për diskutim.*

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

**Fatmire Kollçaku,**

**Kryetare e Komisioni**

---